



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu; Përgjegjës i Sektorit: Drejtore e Financës dhe Buxhetit: znj.Almira Muka; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i zyrës së Strehmit: z.Ledion Mullalli

Koordinatorë e proejktit BtF: znj.Vilma Petro

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve!Të nderuar kolegë Këshilltarë i nderuar Kryetar i Bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq e cila është njoftuar disa ditë përpara, më parë të bëjmë një verifikim të korumit të pjesamarsve duke bërë apelin.Ju ftojme të miratojmë rendin e ditës? Rendi i ditës përbëhet nga 11 pika po tështojmë dhe diskutime të tjera.Kemi diçka me rendin e ditës? Po ju lexoj rendin e ditës.

Rudina Bregu:Kryetar më fal? Përshëndetje të gjithëve, Përshëndetje Kryetar i Këshillit, Përshëndetje Kryetar i Bashkisë, Përshëndetje kolegë Këshilltar.Jam dakord të miratohet rendi i ditës, por pika 9 nuk duhet të ishte në rend dite, ne e kemi trajtuar këtë çështje, nuk mund ta shqyrtojmë, pa ditur si është trajtuar çështja.Nuk jam dakord që pika 9 të miratohet.


Yllson Ibrahimllari:I nderuar Kryetar i Këshillit, i Kryetar i Bashkisë, të nderuar kolegë, nenuk po marim fuqi ligjore për të miratuar ose jo këtë propozim, kjo është një iniciativë e bazuar në rregullore që i paraqiet Këshillit, do shkojë në Komisionin përkatës sa të formohet, pastaj do i shkojë Kryetarit të Bashkisë, pastaj ky projekt-propozim do kalojë në Këshilli, kjo është një iniciativë që ne e paraqesim, ashtu si mund të ketë iniciativë të tjera nga Këshilli.Nuk është kërkesë që e dërgojmë sot dhe do e miratojmë, por është një këkresë ide.

Ornildi Demollari:Rudina Bregu tha që këshilli ka të drejtë të miratojë rendin e ditës dhe kjo pikë nuk ka marrë dakortësinë e zyrës përkatse, Këshilli ka të drejtë të miratojë rendin e ditës.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: Përshëndetje të gjithëve! Materialin e kam parë rastësisht dhe nuk e kam kuptuar se çfarë, kërkohet nga Këshilltari.Këshilli nuk ka kompetencë për hartimin e rendit të ditës, por kjo nuk ja heq të drejtën asnjë Këshilltari që bëjë propozime ti çojë pranë drejtorisë juridike dhe të vijë propozim i duhur për të marrë vendim.Në këtë aspekt nuk jam dakord që ljo të ishte pjesë e rendit të ditës dhe nuk duhet të bëhet praktikë të hyjnë në rendin e ditës materiale si ky, nga ana tjetër dua të bëj me dije se për këtë park ka një vendim të KKRT-së që është miratuar në vitin 2020, nëse ka propozime konkrete ti dërgohet zyrës juridike dhe ata të shprehen, pastaj Këshilli nëse është në të mirë të komunitetit ta shikojë me përparësi.

Ornildi Demollari:Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari:Rregullorja e Këshillit neni 22, thotë që këshilli në konsultim organizon mardhënie me Këshilla të tjerë brenda dhe jashtë, neni 54 pika 2 çdo Këshilltar ka të drejtë të nisë nisma dhe ti mbështeti ato, neni 92, pika 6 propozimet që bën, propozimi im është konform





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

rregullores të Këshillit, kjo zonë nuk është e mbrojtur, kemi kërkuar ndryshin e statusit nga Mesmali deri te Lenia dhe pjesa e bashkisë Grmash ka dy Liqene të mbrojura, Pogradeci tre, ne nuk kemi asnjë.

Ornildi Demollari:Nuk kemi asgjë me propozimin, por Këshilli ka të drejtë të miratojë rendin e ditës.Miratojmë rendine e ditës? Duke hequr pikën 9.

Kush është dakord ? 3 vota

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? 1 votë

Miratohet me 23 vota pro, 3 kundra, 1 abstenim. Faleminderit!

Ornildi Demollari:Kalojmë te pika e radhës, më lejoni tju njoh me vednimet e mbledhjes së kaluar, kemi tre vendime me karketer normativ të cilët kanë marrë dakordësinë e Prefektit të Qarkut dhe pesë vendime me karketer kolektiv, që nuk dërgohen pranë Prefektit të Qarkut.Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Kemi të bëjmë me një rast shëndetësor në fshatin Pojan, znj ka nevojë për kujdes shëndetësor në shtëpi, duhet të ketë apartuarë oksigjeni, ka probleme me frymarjen.

Yllson Ibrahimllari:Qyetatases do ja siguroj unë aparturën falas.

Ornildi Demollari:Ju faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 27 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Planit “Programi 5-vjeçar i Strehimit Social 2023-2028, për Bashkinë Maliq”;

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Kjo është një procedurë standarte që e miraton çdo bashki.

Aleksandra Spaho:Komisioni i Strehimit pranë Këshillit e ka miratuar këtë dokument?


Përgjegjës i zyrës së Strehimit: z.Ledion Mullalli: Kjo është një procedurë standarte, nuk ka nevojë të kalojë në Komisionin e Strehimit.

Ornildi Demollari:Ju faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Miratohet me 27 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e planifikimit të shpenzimeve për shërbimin e pastrimit, grumbullimit, largimit të mbetjeve urbane dhe gjelbërimit për Bashkinë Maliq dhe Njësitë Administrative Libonik, Pojan, Vreshtas dhe Pirq"; Ka ndonjë pyetje?

Aleksandra Spaho:Atje ku nuk ofrohet shërmimi i gjelbërimit, pse ka tarifë shërbimi?

Petrit Kupe:Ka ndonjë ndryshim te çmimet?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Të dyja pyejtet nuk kanë të bëjnë me materialin, por me Paktën Fiskale që miratojmë në fund të vitit.Kemi filluar të vendosim kazanë të rinj, duke u nisur nga shqetësimet e fshatrave të mëdhenj si Podgoria apo Zvezda, nga ana tjetër përlllogartijet janë bërë më vete për Nj.A për çdo fshat, janë shtuar sipërfaqe e pastruara atje ku nuk ka pataur asfalt me parë , të cilat kërkojnë mirëmbajte,në kët aspekt është bërë një punë e mirë nga Komisioni përaktës dhe nga ata që punojnë prej rreth 1 muaji për të bërë një material bruto për këtë qëllim.Në territorin e bashkisë ne pagujamë 1500 lekë, po të shikosh bashkitë e tjera dhe ato janë online të gjitha, shkojnë 2500-3000 lekë, ne kemi qenë të kujdesshëm për këtë punë dhe po mendojmë çfarë propozime do ju sjellim në fund të vitit, buxheti 2024.

Ornildi Demollari:Kjo që thotë Petriti do shikohet në buxhet pastaj?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Patjetër, nuk ka të bëjë me materialin që ju kemi prezantuar.

Ornildi Demollari:Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?


Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 27 vota pro. Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Raportit të II-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për 8-mujorin e vitit 2023";

Ornildi Demollari:Ka ndonjë koment? Nuk ka ndonjë material?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu:Materialin ja u kemi prezantuar, shifrat janë të publikuara dhe nuk lëvizim dot, ky Raport jep një pasqyrë aktuale dhe të të ardhurave dhe shpenzimeve për gjithë bashkinë, kemi realizim të buxhetit 43% deri në këtë moment, të ardhurat për 8-mujorin janë 93 milion 658 lekë , të ndara në të ardhura tatimore dhe jo tatimore, sipas pasqyrës që ju është bashkangjitur.Raporti i shpenzimeve në fund të 8-mujorit është në nivel 71.5 % këto shpenzime duket të ulta për efekt të 2-3 projekte që nuk janë nga fondet e bashkisë, por janë projekte si Ujësjetllsi i Mançurishtit, një stacion pompimi që po bëhet në Vreshtas dhe një ushqyeshi i rezervuarit nga Vërçuni në drejtim të Podgories për të shtuar sasinë e ujit vitin që vjen, janë fonde disponibël, që nuk mund të likujdohen pa përfunaduar vepra.Raporti i shpenzimeve sipas programve jepet dhe për administratën, jepet shërbimet Policore, shërbimin





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ndaj zjarrit që vijoje nga 60-100%, bujqësia, rrugët rurale dhe ng ajo e përgjithshme nga ajo që dua tju deklaroj, është se ka një rritje krahasuar me një vit më parë, do të thotë që është punuar me përgjegjësi për realizimin e shpenzimeve, të cilat janë planifikuar në buxhetin 8-mujor të bashkisë. Kjo nuk do të thotë që nuk ka vend për punë më të mira! Ndaj kjo bëhet dhe për anëtarët e Këshillit të bashkisë, por dhe për qytetarët që e kanë online në faqen e bashkisë, por dhe për ne si organ ekzekutiv që duhet të përmirësojmë punën në vartësi të programeve.

Ornildi Demollari: Je te Raporti i Monitorimit, por po i shpjegon të dyja! Kemi diçka te monitorimi i buxhetit? Jemi te pika 6. Po Petrit.

Petrit Kupe: Nuk më duket normale, realizimi i të ardhurave 43% dhe jemi në 8-mujor, ndoshta duhet parë cila është arsye e mos vjeles apo planit të lartë, megjithëse është bërë një punë e mirë.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: Ka dy momente, është e drejtë ndërhyrja që bëri Petriti, e para që harohet një buxhet pa rezerva, pasi në bazë të buxhetit edhe planifikojmë dhe e dyta janë drutë e zjarrit që ne bëjmë planifikim si e ardhur dhe si shpenzim që kap një vlerë të konsiderueshme rreth 60 milion lekë, të cilat ne i hedhim në buxhet, por nuk e kemi realizuar as si shpenzim as si të ardhur dhe kjo e ka efektin në buxhet.

Aleksandra Spaho: Realizimi të ardhurës nga ujitja është 8%, me sa di unë në zonën time Pirc dhe Zvirinë e paguajnë këtë tarifë, pse nuk është realizuar?

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: Janë disa vlera, që hidhen si shifër në buxhet, duke e planifikuar, duke menduar që do vaditen rreth 1000 ha, pa ditur sa do mbushen rezervaurët dhe ky vit ka patur efekte negative, i cili ka patur një nivel të ulët të mbushjes së ujë-mbledhësve, në Podgorie dhe Leminot. Por patjetër që atje ka vend për rishikim dhe kontroll dhe patjetër që ajo shifër duhet të reflektojë urgjentish në përmirësim të punës tonë.

Ornildi Demollari: Ju faleminderit! Ka diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet pika 6 me 27 vota pro. Faleminderit! Tan i shkojmë te pika 7.

Kryetari i Bashkisë: z.Gëzim Topçiu: Po vazhdoj Raportin e Performancës për vitin 2022.

Përmbledhje e Raportit (perskrim sipas programeve)

Viti 2022 syno i te jetë një vit i rimëkëmbjes pas dy viteve të vështira pandemike, nderkohe qe ka vijuar punaper permbushjen e objektiveve percaktuara ne PBA 2022-2024 si dhe ne Planin buxhetor per vitin 2022

Në vija të përgjithshme performanca e shërbimeve për vitin 2022 tregon se:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ne programin Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Bashkia gjatë vitit 2022 ka rritur kapacitet e burimeve njerëzore. Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Është dyfishuar numri mesatar i ditëve të trajnimit për një person të trajnuar. Është ulur numri i personave që kanë lëvizur nga puna, duke rritur qëndrueshmërinë e administratës.

Është ulur koha e shërbimit të popullatës nga ana e gjendjes civile duke u shërbyer me shpejt dhe më mirë.

Bashkia dhe këshilli bashkiak kanë qenë më transparent duke bërë konsultim me publikun për buxhetin dhe paketën fiskale dhe realizuar 100% mbledhje të hapura për publikun.

Per kete program, Bashkia ka realizuar shpenzime në masën 87% të planit 2022.

Ne programin Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja civile:

Qendra e Zjarrfikeses eshte funksionale dhe ka rritur performancen e saj.

3 mjete dhe 14 persona personel, te trajnuar

Eshte ngritur sistemi I grupeve vullnetare te shpetimit ne te gjithë zonat e rrezikuara nga zjarri

Efikasiteti dhe shpejtësia në dalje nga qendra ne nje kohe prej 40 sekondashdhe mbëritje në vendngjarje bëhet në kohë reale duke minimizuar në këtë mënyrë dëmet në pronë dhe jetë.

Me një realizim prej 98% në një numër total prej 121 ngjarjesh të menaxhuara për shuarjen e zjareve dhe shpëtimit tregon për një punë shumë të mirë të kryer nga stafi i MZSH Maliq.

Ne programin Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit:

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes kullimit në bashkinë Maliq ka një realizim prej 99% për vitin 2022, ku futen pastrimi i kanaleve kulluese me mjetet e bashkisë, dhe përmirësimi i infrastrukturës për ujitjen e sipërfaqeve tokë për fermerët.

Shpenzimet për të realizuar këtë janë në vlerën 62099 mijë lek nga të cilat 49382 mijë lek janë shpenzime për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues dhe 12717 mijë lek janë shpenzime për investime të programit ujitje kullimi.

Për të mundësuar ujitjen e tokave bujqësore bashkia ka vënë në dispozicion 6 rezervuare me ujë.

Bashkia disponon rreth 583 km linear rrjet kullues dhe për vitin 2022 jane rikonstruktuar 755 km ndërsa për sa i përket rrjetit ujitës në total janë rreth 82 km linear.

Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me rrjet ujitës është 8903 ha.


Bashkia mirëmban dhe pastron 32 km rrjet ujitës dhe 32 km rrjet kullues dhe ka rikonstruktuar 31 km linear kanale ujitëse për këtë vit.

Bashkia ka në pronësi të saj dhe 4 diga të cilat i mirëmban.

Ne programin Administrimi pyjeve dhe kullotave:

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosur në Maliq ka një realizim prej 100%.

Janë bërë rreth 750 kontrole dhe inspektime të fondit pyjor dhe kullosur për një sipërfaqe prej 32.536 ha pyje dhe kullota, nga të cilat janë 25.847 ha fond pyjor dhe 6.649 ha fond kullosor, nga të cilat janë dhënë me qera 17.8 ha.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Datë 29.09.2023

Prot.8 (tetë)

Protokoll nr. 8

I mbajtur sot më datë 29.09.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
4. P-V "Për miratimin e Planit "Programi 5-vjeçar i Strehimit Social 2023-2028, për Bashkinë Maliq";
5. P-V "Për miratimin e planifikimit të shpenzimeve për shërbimin e pastrimit, grumbullimit, largimit të mbetjeve urbane dhe gjelbërimit për Bashkinë Maliq dhe Njësitë Administrative Libonik, Pojan, Vreshtas dhe Pirq";
6. P-V "Për miratimin e Raportit të II-të të Monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për 8-mujorin e vitit 2023";
7. Prezantimi i Raportit të Performancës për bashkinë Maliq viti 2022.
8. Ngritja e Aleancës së grave Këshilltare të Këshillit të Bashkisë Maliq.
9. Kërkesë për zgjerimin e kufijve të Peisazhit të Mbrojtur "Guri i Nikës-Lenie-Valamarë dhe propozimin për ndryshimin e katekorizimit në bërjen Park Kombëtar" (propozuar nga Këshilltari z.Yllson Ibrahimllari).
10. Informacion i kërkuar nga grupi i Këshilltarve Opozitarë në mbledhjen e datës 31.08.2023.
11. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Eriseld Jonusllari; Floreta Zaçe; Pranvera Begolli; Klea Baçi; Enida Avdolli; Dritan Çami; Aramando Dautllari; Marianthi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Lulëzim Hoxhaj; Danjela Ibrahim; Ronaldo Skënderi; Fevri Sherifi; Faslli Zholi; Ilia Xhuti; Gentiana Drabo; Aleksandra Spaho; Eglantina Balli; Albina Xhejo; Ildir Limllari; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Server Xhuri; Andonaq Risto; 27 (njëzetëeshtatë) këshilltarë.

